



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PRESIDENTI

26 Prill 2022 Presidenti Meta dekreton emërimin e z. **Darjel Sina gjyqtar i Gjykatës së Lartë**

DEKRET

PËR

EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 136 të Kushtetutës, nenit 49, pika 11, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi administrova propozimin e arsyetuar të përcjellë me shkresën me nr. 2032/3 prot., datë 19.04.2022 dhe Vendimit nr. 133, datë 06.04.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. Darjel Sina", shoqëruar me praktikën dokumentuese të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatëve nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, procedurë kjo e shpallur për kandidim me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përfundim të shqyrtimit të këtij propozimi, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti **Darjel Sina** emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Nr. Dekretit 13573

Tiranë, më 26.04.2022

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META

Shpërndaje në Rrjetet Sociale:



Arkiva

Shtator 2018

Gusht 2018

Korrik 2018

Qershor 2018

Maj 2018

Prill 2018

Mars 2018

Shkurt 2018

Janar 2018

Dhjetor 2017

Nëntor 2017

Tetor 2017

Lidhje shtetërore

Kuvendi i Shqipërisë

Këshilli i Ministrave

Gjykata Kushtetuese

Gjykata e Lartë

Prokuroria Shqiptare

Shtabi i Përgjithshëm i FA

Kontrulli i Lartë i Shtetit

ILDKP

Avokati i Popullit

Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Kolegji i Posaçëm i Apelit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Avokatura e Shtetit